



**REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA - DRENAS
DREJTORATI PËR SHËRBIME
PUBLIKE DHE EMERGJENCË**

Dt. 14/09/2023



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		13 / 09 / 2023	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
13	MM/01	96319	

Në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-179, për Transportin Rrugor ,nenit 15,pargrafi 2, nenit 8,paragrafi 2 i Rregullores për Transportin Rrugor, në territorin e Komunës së Drenasit me nr.06-7086, dhe Vendimit të Kuvendit për miratimin e linjave urbane-periferike në komunën e Drenasit nr. 12-031-14044, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë rishpallë:

KONKURS PLOTËSUES

Për linjat Urbano - Periferike të transportit të rregullt të udhëtarëve me autobus të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit, për të gjithë Operatorët e licencuar nga Ministria e infrastrukturës, bazuar në ligjin për Transport Rrugor, për linjat në vendbanimet për të cilat kompanitë nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit dhe për disa nuk kemi pasur të interesuar në konkursin e shpallur me herët.

Komuna fton të gjithë Operatorët e licencuar të transportit rrugorë të udhëtarëve me autobus, të interesuar që të aplikojnë për linjat si në vijim:

LINJAT:

1. **Drenas-Poklek i vjetër- Vasilevë,**
2. **Drenas-Gradicë-Godanc,**
3. **Drenas-Kizharekë.**

Kushtet për aplikim:

1. Kërkesën për aplikim;
2. Licencë për transport të udhëtarëve me autobus, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës;
3. Rendin e udhëtimit ku përfshinë: Emrin e operatorit, relacionin, radhitjen e vend-ndaljeve dhe largësinë e tyre nga pika fillestare në km , kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në çdo stacion dhe vend-ndalje, ditët e operimit (periudha kohore në të cilën mbahet linja);
4. Vërtetim më të cilin vërtetohet se nuk është iniciuar ndonjë procedurë e pezullimit apo revokimit;
5. Vërtetimi i lëshuar që vërteton se Operatori Ekonomik nuk ka borxhe të pashlyera të taksës komunale deri në vitin 2023;
6. Vërtetim (jo më të vjetër se 30 ditë nga ATK-ja për kontributet e paguara nga kompanitë, (së paku në 6 muajt e fundit), kopjet e kontratave të punës për shofer, patent - shoferi-kopje;
7. Dëshmi për kapacitetet përkatëse të autobusëve (kopjet e librezave të qarkullimit dhe certifikatave të autobusëve të noterizuar)

Mënyra e Aplikimit:

Aplikacioni i plotësuar së bashku me dokumentacionin duhet të dorëzohet në zyrën pritëse- kati i parë, Dokumentacioni dorëzohet në dy kopje, në dy zarfe të mbyllura prej të cilave në njërin duhet të jetë origjinali ndërsa tjetra kopje, të shënuara (të mos hapet).

Komisioni do të zgjedhë Operatorët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në shpallje publike.

Aplikacionet hapën në zyrat e Komunës.

Aplikacionet e pa nënshkruara dhe të pavulosura nga Menaxheri i Operatorit të Transportit nuk do të shqyrtohen dhe do të konsiderohen si të anuluar.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë, nga dita e shpalljes, nga dt:14.09.2023 deri me 21.09.2023, ora 16:00

Aplikacionet merren në sportelet e zyrës pritëse.

Vërejtje:

Linjat:

Për Godanc duhet të mbahet duke qarkulluar nga rruga kryesore e fshatit dhe hynë deri lagja Fazliu dhe deri tek ish Shkolla Filllore e Mesme e ultë.

Për Gradicë duhet të mbahet duke qarkulluar nga rruga kryesore deri tek L.Bardhi,

Për Poklek -Vasilevë , linja duhet të mbahet duke qarkulluar deri të lagja Bresila.

Nisja e fundit prej Drenasi duhet të jetë prej orës 18:45-19:15, vlen për të gjitha linjat.



DREJTORI I DREJTORISË

Nexhmedin V. Gruda